



VENDIM

Nr.125 Datë. 01.12.2014

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË  
“DRAGOBIA ENERGY”SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT  
TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9; 13 pika 1 gërma “ç”; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 5 pika 1 gërma “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “ DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

Për Dokumentacionin e Përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit : është plotësuar në mënyrë korrekte

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.( Mungon struktura e ndertimit dhe funksionimit administrativ e shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.  
(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Neni 9, pika 4/9, gërma a,b dhe c janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “**DRAGOBIA ENERGY**” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË**  
Bordi i Komisionerëve



---

**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

VENDIMIN

Nr.125 Datë. 01.12.2014

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË  
“DRAGOBIA ENERGY”SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT  
TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____